



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Ilir Hetemi, nga fshati Klinë e Mesme , 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

E PADITUR: QEVERIA E REPUBLIKËS SE SERBISË BEOGRAD, rr. e Nemanjës nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 844440

1.) Paditësit me datën 15.04. 1999 në oborr të shtëpisë në prezencë te familjes nga forcat serbe i është vrarë babai Vesel Hetemi i lindur më 01.04.1949.Nga tmerrri i par te gjithë anëtarët e familjes kanë mbet te shokuar dhe kanë vuajtje shpirtërore,ndërsa vajza e Veselit Teuta ka psuar me se keqi meqe nga traumat e luftës ka fituar diabetin,sëmundje e pashterueshme,e cila ka me e përcjell tan jetën dhe e varur nga barërat.

Provë : - Vërtetimi nga D.SH.M.S. 08Nr. 580 te datës 07. 01.2009

- Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës, nr. 580-96 ,e datës 27.01.2009

- Raportet e specialistit internist endokrinolog te datës 26.01.2009 dhe 29.06.2009

- Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL-72015018 - 00177 e datës 21.01.2009 dhe UL-72015064-00018 të të njëjtës datë

2.) Paditësi se bashku me 7 anëtarët e familjes është detyruar ta braktis shtëpinë nga data 15.04.1999,dhe për dy muaj, respektivisht deri ne përfundim te luftës ka qëndruar tek një i afërm me emrin Mustafa.Ne deklaratë thekson se shtëpinë e ka afër pyllit dhe kohë pas kohe gjatë ditës kanë qëndruar ne male përreth shtëpisë ndërsa ne shtëpi jam kthyer në orët e vona te natës, kurse pas vrasjes së babait ,babgjyshit dhe tre vëllezër te babagjyshit definitivisht u është dashtë ta braktisin shtëpinë deri ne përfundim te luftës.

Provë : - Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 035/236 e datës 26.01.2009

- Certifikata e vdekjes për Vesel Hetemin nr.rendor 9 e datës 23.01.2009

- Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit,325-103 i datës 22.01.2009

- Vërtetimi i DSHMS 08 nr.580 i datës 27.01.2009

3.) Babai i paditësit Vesel Hetemi si rezultat i vendimit politik është larguar nga vendi i punës arsimtar i lëndës së matematikës në shkollën fillore “Shote Galica” në Runik qe nga fillimi i vitit kalendarik shkollor 1990/91

Provë : - Vërtetimi i Shkollës Fillore „ Shote Galica ” në Runik nr.prot.113 i dt.26.06.2009

- Dëgjimi i paditësit anëtarëve tjerë të familjes dhe provave te tjera te cilat paditësi do ti prezantoj ne seancat e shqyrtimit kryesor dhe ne rast nevojte te caktohet edhe eksperti përkatës.

4.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në nenin 185 te LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 te te njëjtit Ligj , me te cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë te personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qen e obliguar te pengoj aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes se pasurisë se paditëses .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (neni 1 Protokolli nr. 1 , neni 2 dhe protokolli nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor te çështjes , t’i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bien këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesë padija e paditësit Ilir Hetemi nga fshati Klinë e Mesme , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Qeveria e Serbisë si pasardhëse juridike e Qeverisë se me parshme qe ne emër te te njëjtës te kompensoj demin material dhe jo material paditësit Ilir Hetemit ,nga f.sh.Ticë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 600 000 €për vrasjen babait
 - shumen prej 100 000 për çrregullimin shëndetësor te motrës Teuta Hetemi si pasojë e luftës
 - shumen prej 8 400 €për dhembjen shpirtërore dhe te munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi ne qiell te hapur dhe shtëpi te huaja ne kohëzgjatje prej 2 muaj
 - shumen prej 50 000 për shkak te pamundësuarit e kremtimit te festave fetare ne shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
 - shumen prej 41 440 €për largimin e viktimës Vesel Hetemi nga puna si rezultat i vendimit politik ,kompensimi nga fillim viti 1990.91 deri me 15.04.1999,ditën kur është vrarë
 - shumen prej 31 200 €për shtëpinë e djegur dhe te shkatërruar,
 - shumën prej 10 000 € për ter teknikën e bardhe në sallon dhe mobilierin e dhomave te gjumit.
 - shumën prej 3 400 për 4 krerë lopë, dhe 20 cop pula
 - shumën prej _____ €për pamundësinë e punimit të tokës bujqësore për një vit .
- te gjitha këto shuma me kamat ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarrimit te dhunshëm .

Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarrimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirim nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .
Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi

Illir Hetemi


Shtojcë ;

1. Vërtetimet nga D.SH.M.S. 08 nr.580 i datës 27.01.2009
2. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës, nr. 580-96 ,e datës 27.01.2009
3. Raportet e specialistit internist endokrinolog te datës 26.01.2009 dhe 29.06.2009
4. Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL-72015018 - 00177 e datës 21.01.2009 dhe UL-72015064-00018 të të njëjtës datë
5. Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 035/236 e datës 26.01.2009
6. Certifikata e vdekjes për Vesel Hetemin nr.rendor 9 e datës 23.01.2009
7. Vërtetimi i Shkollës Fillore „ Shote Galica ” në Runik nr.prot.113 i dt.26.06.2009
8. Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit,nr. 325-103 i datës 22.01.2009
9. 4 kopje te padisë